

# NGA VIJNË QENTË ENDACAK?

**Qentë endacak** janë një problem i krijuar **nga njeriu**.  
Çdo qen endacak **ishte dikur kafsha e dikujt**,  
ose **këlysh** i një qeni që dikur ishte braktisur.



# JANË 3 BURIME TË QENVE ENDACAK:

## KATEGORIA 1



### QENTË E HUMBUR

## QENTË E HUMBUR

- Mbani qenin në mjedis të kontrolluar në mënyrë që të mos largohet nga shtëpia
- Sigurohuni që qeni të regjistrohet tek veterinari me mikroçip dhe të mbajë qafore me emrin e qenit dhe të dhënat e pronarit.
- Kastro/sterilizo qenin, për benefite shëndetësore dhe për parandalimin e lindjeve të këlyshëve.

## KATEGORIA 2



### QENTË E BRAKTISUR

## QENTË E BRAKTISUR

- Një familje nxiton të marrë një qen duke mos qenë plotësisht e vetëdijshme për përgjegjësinë e madhe për të mbajtur qen
- Një veprim i papërgjegjshëm dhe i paligjshëm i familjes që nuk dëshiron të mbajë më qenin është braktisja e qenit, shpesh në ndonjë vend malor dhe të largët, në mënyrë që qeni të mos mund të kthehet në shtëpi
- Qentë femra me mbajtës/pronar, që nuk janë të sterilizuar dhe që janë ose të lidhur me zinxhir jashtë për të "mbrojtur" shtëpinë, ose që lejohen të bredhin lirshëm jashtë ambienteve të shtëpisë, riprodhohen me qen të tjerë në rrugë që janë të pa kastruar dhe kështu lindin këlyshë vazhdimisht. Këlyshët zakonisht braktisen në rrugë.

## KATEGORIA 3



### QENTË E LINDUR NË RRUGË

## QENTË E LINDUR NË RRUGË

- Shumë prej qenve endacak janë gjenerata e dytë ose e tretë e qenve në rrugë, pasi që paraardhësit e tyre janë braktisur në rrugë.

## 1. QENTË E HUMBUR



Një burim i qenve endacak është **humbja** e një qeni që kishte dikur një shtëpi/familje. Mbjatësit e përgjegjshëm të qenve duhet të kujdesen që qentë e tyre **të jetojnë në një mjedis të kontrolluar** dhe të **mos mund të bredhin**.



Mbjatësit e qenve gjithashtu duhet të sigurojnë që qentë e tyre të kenë **qafore me etiketë që përmban të dhënat e pronarit (telefoni apo adresa)**, ashtu që në rast të humbjes së qenit, të ketë më shumë gjasa për ribashkim me pronarin.



Të gjithë mbjatësit/pronarët e qenve, duhet t'i identifikojnë qentë e tyre me **mikroçip** dhe t'i regjistrojnë ata së bashku me të dhënat e tyre personale në Regjistrin Qendror të të dhënave për regjistrimin e kafshëve;

Çdo qendër veterinare mund të përdorë një lexues (skaner) të mikroçipit për të identifikuar pronarin e qenit dhe për të ribashkuar atë me qenin e tij të humbur. Identifikimi dhe regjistrimi i qene me mikroçip është obligim ligjor.

## 2. QENTË E BRAKTISUR



Fatkeqësisht burimi kryesor i qenve endacak **është braktisja e qëllimshme e qenve nga pronarët e tyre**. Situatë tipike është kur familjet nxitojnë të marrin një qen duke mos qenë plotësisht të vetëdijshme për përgjegjësitë e të qenit pronar i qenit.

Braktisja e qenve përveç që është jashtëligjore dhe joetike, po ashtu rrezikon jashtëzakonisht shumë mirëqenien e qenve të braktisur, të cilët shpesh edhe nuk mbijetojnë të vetëm në rrugë.



Një tjetër arsye e braktisjes është edhe **shtatzënia e padëshiruar e qenve femra**. Këto shtatzëni janë rezultat i qenve femra që nuk jetojnë në mjedise të kufizuara (p.sh. janë të lidhura me zinxhir jashtë për të "mbrojtur" pronën ose lejohen të bredhin lirshëm jashtë shtëpisë) që vijnë në kontakt me qen në rrugë, që janë të pa kastruar.



Shtatzënitë e padëshiruara rezultojnë në lindje të këlyshëve të cilët braktisen pasi përpjekjet fillestare për t'i adoptuar dështojnë. **Deponitë e mbeturinave janë vende të zakonshme të braktisjes së këlyshëve të padëshiruar.** Shumica e këtyre **këlyshëve të braktisur** kanë shkallë të ulët të mbijetesës, pjesërisht sepse ata ende kanë nevojë për qumësht të nënës dhe nuk mund të mbijetojnë me mbetjet e ushqimit njerëzor siç do të bënin qentë e rritur.

### 3. QENTË E LINDUR NË RRUGË



**Shumë qen thjesht lindin në rrugë.** Në shumicën e rasteve, ata janë të **brezit të dytë ose të tretë** pasi prindërit ose gjyshërit e tyre janë braktisur më parë.

Qentë femra të pasterilizuara janë në afsh dy herë në vit dhe, nëse riprodhohen, do të lindin çdo gjashtë muaj mesatarisht nga **shtatë këlyshë**, varësisht nga madhësia dhe raca e tyre. Prandaj, një qen i gjinisë femërore mund të lind mesatarisht **14 këlyshë në vit**. Edhe pse jo çdo qen i mbijeton kushteve të vështira në rrugë, cikli i qenve të lindur në rrugë vazhdon me çdo qen që braktiset.



Fondacioni për të Drejtat e Kafshëve  
Animal Rights Foundation  
Fondacija za prava životinja